



Buletini mujor

Qershor 2026



Kryetari i KLSH-së paraqet “Raportin e veprimtarisë vjetore 2025” në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Në datë 15.06.2026, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, paraqiti në Komisionin Parlamentar për Ekonominë, Punësimin dhe Financat “Raportin e veprimtarisë vjetore 2025”.

Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH-së prezantoi rezultatet kryesore të veprimtarisë audituese për vitin 2025, e cila është orientuar drejt forcimit të kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike dhe administrimin e pasurisë shtetërore, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Z. Shehu bëri të ditur se, gjatë vitit 2025, KLSH ka zhvilluar 190 auditime në 271 subjekte. Kryetari i KLSH-së theksoi se auditimet e kryera kanë konkluduar me dhënien e 222 opinioneve, mesazheve dhe konkluzioneve, si dhe 4994 rekomandimeve, të cilat përfshijnë 29 propozime për përmirësime të kuadrit ligjor, 3268 masa organizative, 281 masa për shpërblim dëmi, 441 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar dhe 975 masa disiplinore dhe administrative.

“Këto masa kanë synuar adresimin e problematikave të konstatuara, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, me qëllim përmirësimin e administrimit të fondeve publike, në funksion të shmangies së përsëritjes së tyre në të ardhmen”, u shpreh z. Shehu.

Z. Shehu vuri në dukje më tej në fjalën e tij se një tregues i rëndësishëm për rritjen e ndikimit të auditimit dhe përmirësimin e performancës së institucioneve publike mbetet niveli i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. Gjatë vitit 2025 është verifikuar zbatimi i rekomandimeve në 125 auditime të mëparshme, ku rezultoi se rreth 99% e tyre janë pranuar nga institucionet e audituara, ndërsa 70% janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi.

Duke u ndalur në problematikat e konstatuara në auditime, Kryetari i KLSH-së evidentoi se, nga veprimtaria audituese e zhvilluar gjatë vitit 2025, është konstatuar një dëm ekonomik dhe efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit me vlerë totale 26.2 miliardë lekë.

Më tej, z. Shehu informoi mbi zhvillimin profesional të stafit, bashkëpunimin ndërkombëtar, zbatimin e rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit etj. Gjatë seancës dëgjimore u diskutua mbi gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me pasqyrat financiare, sigurinë ushqimore, sektorin e shëndetësisë dhe menaxhimin e pronave shtetërore.

Në përfundim, z. Shehu theksoi angazhimin e KLSH-së për forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe administrimit më të mirë të fondeve dhe pasurive publike, në funksion të interesit të qytetarëve.

Kryetari i KLSH-së priti në takim Ambasadorin e Turqisë në Shqipëri, z. Barış Ceyhun Erciyes

Më 29 qershor 2026, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, priti në një takim Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Shqipëri, Shkëlqesinë e Tij, z. Barış Ceyhun Erciyes. Z. Shehu i shprehu Ambasadorit mirënjohjen për vizitën dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit të dy vendeve.

Nga ana e tij, Ambasadori Erciyes falënderoi z. Shehu për mikpritjen dhe shprehu vlerësimin e tij të lartë për marrëdhëniet dypalëshe dhe për rolin dhe kontributin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes.

Gjatë bisedës, vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit të konsoliduar ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive, duke vënë theksin në qëndrueshmërinë e këtij partneriteti institucional dhe rëndësinë e auditimit të jashtëm publik si një instrument kyç në shërbim të llogaridhënies. Ambasadori Erciyes shprehu angazhimin e tij të plotë për mbështetjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit midis institucioneve homologe të auditimit dhe më gjerë.



KLSH – SECO nënshkruajnë marrëveshje për forcimin e auditimit në mbikëqyrjen e sektorit financiar bankar dhe jobankar në Shqipëri

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, znj. Ruth Huber, nënshkruan në datë 16.06.2026, Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), për zbatimin e projektit “Nga auditimi në veprim”, gjatë periudhës 2026–2029. Projekti “Nga auditimi në veprim” - “From Audit to Action” (A2A) synon të forcojë kapacitetet e auditimit për mbikëqyrjen e sektorit financiar bankar dhe jobankar në Shqipëri dhe t'i shndërrojë vëzhgimet e auditimit në mbikëqyrje të vërtetë dhe menaxhim më të mirë të burimeve publike. Një element i rëndësishëm i projektit është forcimi i lidhjes ndërmjet auditimit publik dhe mbikëqyrjes parlamentare.

Për këtë qëllim, projekti parashikon bashkëpunim edhe me National Democratic Institute (NDI Albania) dhe Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta, me synim forcimin e lidhjes ndërmjet auditimit publik dhe mbikëqyrjes parlamentare.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të SECO-s dhe Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, duke theksuar se ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale të KLSH-së dhe në rritjen e ndikimit të auditimit publik, në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të financave publike.

Nga ana e saj, Ambasadorja Ruth Huber, rikonfirmoi angazhimin e Zvicrës për të mbështetur institucionet shqiptare në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, duke vlerësuar rezultatet e arritura nga bashkëpunimi me KLSH-në dhe potencialin e projektit të ri për të sjellë ndikim të qëndrueshëm në sektorin publik.



Me këtë marrëveshje, KLSH dhe SECO riafirmojnë angazhimin e përbashkët për forcimin e auditimit të jashtëm publik si një instrument kyç për transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin më efikas të fondeve publike në Shqipëri.

Marrëveshja e re shënon vazhdimësinë e partneritetit të suksesshëm ndërmjet KLSH-së dhe SECO-s, i ndërtuar mbi rezultatet e projektit të mëparshëm “Forcimi i auditimit të jashtëm lidhur me mbikëqyrjen e koncesioneve dhe Partneriteteve Publik-Private”, i përmbyllur në dhjetor 2024.

Ky projekt kontribuoi në rritjen e kapaciteteve profesionale të KLSH-së për auditimin e PPP-ve dhe koncesioneve, përfshirë realizimin i tri auditimeve pilot, organizimin e një vizite studimore në Gjykatën Turke të Llogarive, si dhe hartimin e “Manualit të Auditimit të PPP-ve dhe Koncesioneve”.



“Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë të qëndrueshme dhe digjitale”

Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi me sukses Konferencën VII Young EUROSAT (YES 2026) me temë “*Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë të qëndrueshme dhe digjitale*”.

Ky aktivitet i rëndësishëm ndërkombëtar për audituesit e rinj nën 35 vjeç u zhvillua në datat 9 dhe 10 qershor 2026 në Hotel Rogner, Tiranë.

Duke shërbyer si kontribuese në ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet brezit të ri të audituesve të EUROSAT-t, përmes promovimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale, konferenca mbledhi në Tiranë mbi 65 auditues të rinj nga 32 Institucione Supreme të Auditimit (SAI) të Evropës dhe për herë të parë përfaqësues të Sekretariatit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit të Azisë (ASOSAI) nga SAI i Kinës. Konferenca u ndoq gjithashtu edhe nga përfaqësuesja e Revistës Ndërkombëtare INTOSAI Journal pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (U.S. Government Accountability Office - GAO).

Konferenca u hap me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, i cili theksoi se “*audituesit e rinj përfaqësojnë forcën më të madhe transformuese në institucionet e tyre dhe se Konferenca Young EUROSAT ka dëshmuar ndër vite se është një hapësirë ku lindin ide të reja, krijohen lidhje të qëndrueshme profesionale dhe ndërtohet një rrjet bashkëpunimi që forcon komunitetin e auditimit publik*.”

Konferencën e përshëndetën gjithashtu edhe znj. Kristie Conserve, përfaqësuese e INTOSAI Journal, si dhe përfaqësuesja e SAI-t të Kinës, në cilësinë e Sekretariatit të ASOSAI-t, znj. Zhang Xian.

Përgjatë dy ditëve të konferencës, audituesit e rinj nga KLSH dhe SAI-t homologe, si: UK NAO, Malta, Republika Çeke, Kina, Norvegjia, Holanda, Letonia, Kosova, Portugalia etj., prezantuan punimet e tyre dhe ndanë përvoja mbi çështje si transformimi digjital dhe efektiviteti nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja; aftësitë, metodologjitë dhe teknologjia në mjediset respektive kombëtare; roli i audituesve të rinj dhe sfidat e përdorimit të teknologjive të reja; qëndrueshmëria, digjitalizimi dhe inovacioni në auditim; reziliencia institucionale; roli i transformimit digjital në zhvillimin e aftësive, risqet e mashtrimit digjital dhe inteligjenca artificiale etj.

Në përfundim të konferencës, Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, falënderoi pjesëmarrësit për prezantimet duke konfirmuar mbështetjen e audituesve të rinj me trajnime dhe mjetet e nevojshme për t'u përballur me sfidat e së ardhmes.

Krahas konferencës, KLSH organizoi për pjesëmarrësit një program social për promovimin e vlerave kulturore shqiptare. Pjesëmarrësit vizituan qytetin historik të Krujës, duke u njohur nga afër me historinë, kulturën, kulinarinë dhe mikpritjen shqiptare.

YES Konferencë 2026

Sesioni I: Inteligjenca Artificiale, inovacioni digjital dhe audituesit e përgatitur për të ardhmen



Në sesionin e parë hapës të konferencës u diskutua mbi rolin e Inteligjencës Artificiale (AI) në auditim, inovacionin digjital dhe përgatitjen e audituesve të së ardhmes. Gjykata Evropiane e Audituesve (*European Court of Auditors – ECA*) prezantoi mënyrën se si teknologjitë, përfshirë Inteligjencën Artificiale, po forcojnë proceset e auditimit. SAI i Kinës paraqiti përvojën e tij në auditimin e bazuar në të dhëna, duke theksuar se teknologjia është një mjet, ndërsa auditimi mbetet qëllimi kryesor. SAI i Maltës prezantoi punën e ekipit të tij për rritjen e efektivitetit të auditimit përmes teknologjive të reja dhe metodologjive inovative. SAI i Kosovës prezantoi Planin e tij të ri Strategjik të IT-së, i fokusuar në teknologjinë, zhvillimin e aftësive dhe qëndrueshmërinë. KLSH theksoi se transformimi nga Inteligjenca Artificiale është po aq një sfidë njerëzore sa edhe teknologjike. Ruajtja e gjykitimit profesional mbetet thelbësore dhe AI duhet të shërbejë si mbështetje, jo si zëvendësim i arsyetimit profesional. Përmes shembujve praktikë u evidentua se njerëzit dhe, jo mjetet, janë katalizatorët e vërtetë të ndryshimit.



SAI I KINËS



SAI I MALTËS



SAI I KOSOVËS



KLSH

Sesioni II: Përtej pajtueshmërisë - Cilësia e auditimit, llogaridhënia dhe vlera publike



KLSH



KLSH

Në sesionin e dytë të konferencës, prezantimet u fokusuan te cilësia e auditimit, llogaridhënia dhe vlera publike.

KLSH prezantoi përvojën e tij si institucion pilot për Standardin e rishikuar ISSAI 140, duke vënë në pah rolin e rëndësishëm të audituesve të rinj në kalimin nga kontrolli i cilësisë drejt menaxhimit të cilësisë së auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit në Britaninë e Madhe paraqiti praktikën aktuale të NAO UK në ciklin e auditimit.

SAI i Suedisë demonstroi përdorimin praktik të Inteligjencës Artificiale në auditimet e performancës dhe ato financiare, duke prezantuar mjete dhe programe që kanë rritur efektivitetin e auditimit.

SAI i Belgjikës trajtoi kompleksitetin e auditimit në një sistem federal me tre komunitete dhe tre rajone, çka sjell mandate të ndryshme auditimi.



SAI I BELGJIKËS



NAO UK



SAI I SUEDISË



SAI I BELGJIKËS

YES Konferencë 2026

Sesioni III: Transformimi digjital në auditimin publik - Nga inovacioni te ndikimi

Sesioni i tretë i konferencës u përqendrua në transformimin digjital në auditimin publik. SAI i Portugalisë prezantoi mënyrën se si integrimi i analizës së të dhënave dhe Inteligjencës Artificiale në proceset e auditimit ka forcuar funksionin mbikëqyrës.

SAI i Sllovenisë ndau rekomandime për transformimin e orientuar drejt së ardhmes, duke përfshirë krijimin e standardeve të përbashkëta për transformimin digjital, programe të strukturuar trajnimi dhe forume për shkëmbimin e praktikave më të mira.

SAI i Republikës Çeke diskutoi mënyrat për kapërcimin e pengesave të digjitalizimit, si cilësia e dobët e të dhënave dhe proceset joefektive, duke ngritur pyetjen nëse janë të përgatitura organizatat ta përdorin AI në mënyrë efektive. KLSH prezantoi se si teknologjia po transformon punën e audituesve përmes përdorimit të AI-së, sistemeve digjitale etj.



Sesioni IV: Nga financat e "gjelbra" te kohezioni social - Auditimi i rezultateve të qëndrueshme

Në sesionin e katërt mbi financat e "gjelbra" dhe auditimin e rezultateve të qëndrueshme, SAI i Spanjës ndau auditime rreth masave rajonale për të promovuar kursimin e energjisë dhe efikasitetin në ndërtesat publike.

SAI i Norvegjisë ofroi një pasqyrë praktike mbi auditimin dhe raportimin mbi OZHQ-të e OKB-së, duke sugjeruar përdorimin e kërkimeve dhe objektivave më të gjera për kriteret përkatëse të auditimit.

SAI i Letonisë prezantoi rolin që luan institucioni i auditimit mbi "financat e "gjelbra", duke kontrolluar nëse investimet publike prodhojnë në të vërtetë rezultate në mbrojtje të mjedisit.



Sesioni V: Audituesi hibrid - Aftësitë, teknologjia dhe vlera publike në një botë në ndryshim

Në sesionin e fundit të konferencës, pjesëmarrësit shqyrtuan kompetencat që do t'u nevojiten audituesve të së ardhmes. Në prezantimin e KLSH-së u paraqit se si ndryshimi digjital po formëson kompetencat që u nevojiten audituesve të rinj.

SAI i Holandës paraqiti një panel kontrolli të PBB-së të dobishëm për të ndjekur progresin drejt qëllimeve specifike në sektorë të ndryshëm dhe për t'u përqendruar në zhvillimet afatgjata.

SAI i Republikës Çeke demonstroi se si kombinimi i auditimit tradicional me një qasje të gatshme për të ardhmen ishte i dobishëm për auditimin e ndryshimit të shpejtë të legjislacionit që lejoi fëmijët ukrainas të përfshiheshin në sistemin arsimor çek.

KLSH paraqiti një perspektivë mbi rreziqet e mashtrimit digjital dhe sfidat e përdorimit të AI-së si një mjet auditimi. "Auditori hibrid" do të duhet të bashkojë kompetencat tradicionale të auditimit me aftësitë digjitale.



YES konferenci 2026



BASHKËPUNIMI ME ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË NORVEGJISË (NAO)



Zhvillohen në KLSH workshop-e me ekspertët norvegjezë mbi përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës dhe Auditimet IT

Në datat 1-3 qershor 2026, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua workshop-i i tretë, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë (*National Audit Office of Norway – NAO*), për përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte vijimi i punës për rishikimin dhe përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës, përmes diskutimit të strukturës dhe përmbajtjes së draftmanualit, me fokus në aspektet metodologjike të procesit të auditimit.

Gjatë workshop-it, audituesit e KLSH-së dhe ekspertët e NAO-s shkëmbyen eksperiencën dhe diskutuan mbi përmirësimin e strukturës së manualit, me synimin për ta përafruar atë me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë në fushën e auditimit të performancës.

Në kuadër të aktivitetit u diskutua gjithashtu mbi auditimin e ri të performancës që do të mbështetet nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Norvegjisë, si dhe mbi hapat e mëtejshëm për vijimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në workshop morën pjesë, nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Norvegjisë, z. Torkel Grahm-Haga dhe z. Bjørn Martin Ørvim, ndërsa nga KLSH, znj. Xhuljeta Çelaj, z. Klarenc Xhaferaj, z. Bajram Lamaj, znj. Megi Kurushi dhe znj. Eva Kushta.

Organizimi i këtij workshop-i kontribuon në forcimin e kapaciteteve profesionale të KLSH-së në fushën e auditimit të performancës dhe në përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë audituese, në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit.

Në vijim të bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë, në datat 15-19 qershor 2026, në Kontrollin e Lartë të Shtetit u zhvillua një sesion trajnues dhe testimi praktik për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj sulmeve "Phishing".

Ky aktivitet, me ekspertët e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë në fushën e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, kishte si synim forcimin e sigurisë së informacionit dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të audituesve IT përmes trajnimit praktik dhe realizimit të një testi të simuluar "Phishing" në mjedisin e KLSH-së.

Trajnimi synoi të rrisë njohuritë dhe aftësitë e audituesve IT mbi planifikimin, organizimin, realizimin dhe analizimin e testeve "Phishing", si dhe të forcojë ndërgjegjësimin e stafit për kërcënimet kibernetike që shfrytëzojnë faktorin njerëzor.

Gjatë workshop-it, ekspertët e të dy institucioneve realizuan një test "Phishing" përmes dërgimit të një email-i të simuluar dhe përdorimit të një faqeje web testuese, me qëllim identifikimin e dobësive të mundshme në nivelin e ndërgjegjësimit dhe praktikave të sigurisë së përdoruesve.

Rezultatet e këtij testimi do të analizohen në vijim dhe do të shërbejnë si bazë për hartimin e aktiviteteve të mëtejshme të ndërgjegjësimit, trajnimit dhe përmirësimit të masave të sigurisë kibernetike.

Ky bashkëpunim konsolidon më tej kapacitetet profesionale të KLSH-së në fushën e sigurisë kibernetike dhe auditimit të Teknologjisë së Informacionit, duke mbështetur një qasje proaktive ndaj menaxhimit të risqeve digjitale dhe mbrojtjes së informacionit institucional.

Workshop-i mbi “Menaxhimin e Cilësisë në Auditim”

Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në workshop-in ndërkombëtar mbi “Menaxhimin e Cilësisë në Auditim”, i zhvilluar më 23-25 qershor 2026 në Stamboll. Workshop-i u organizua nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë në kuadër të aktiviteteve të projektgrupit të EUROSAT-t për zhvillim. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga 12 Institucione Supreme Auditimi, të cilët prezantuan përvojat e tyre lidhur me implementimin e ISSAI 140, duke trajtuar në veçanti mënyrën e zbatimit të standardit në institucionet përkatëse, praktikat që kanë rezultuar të suksesshme, si dhe sfidat e hasura gjatë procesit të implementimit.



Përgjatë tri ditëve të workshop-it, krahas prezantimeve të vendeve pjesëmarrëse, u zhvilluan diskutime profesionale mbi qasjet dhe praktikat më të mira për zbatimin efektiv të ISSAI 140, me fokus në forcimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë në Institucionet Supreme të Auditimit.

Gjithashtu, u planifikuan tema prioritare që do të trajtohen në workshop-et e ardhshme, me synim thellimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e përvojave ndërmjet institucioneve. Nga KLSH morën pjesë në këtë workshop znj. Arminda Bushi, kryeaudituese dhe znj. Laura Lila, këshilltare.

Workshop-i tematik mbi praktikën “Peer Review”



Qëllimi i workshop-it ishte prezantimi dhe zhvillimi i konceptit “Peer Review”, i cili përfaqëson një proces rishikimi të jashtëm, të pavarur dhe profesional të një ose më shumë elementeve të organizimit dhe funksionimit të një Institucioni Suprem të Auditimit (SAI).

Ky rishikim kryhet nga një ekip kolegësh profesionistë të një ose më shumë SAI-ve, në përputhje me standardet e INTOSAI-t. Pjesëmarrja në një proces “Peer Review”, si në cilësinë e institucionit që i nënshtrohet rishikimit ashtu edhe në atë të institucionit që kryen rishikimin, bazohet në parimin e vullnetarizmit. Në takim u diskutuan çështjet kryesore për të cilat një SAI mund të kërkojë zhvillimin e një procesi “Peer Review” nga institucionet homologe. Diskutimet u përqendruan në vlerësimin e shkallës së zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të auditimit, funksionimit e sistemeve të brendshme, identifikimin e mundësive për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë institucionale, përmirësimin e qasjeve, metodologjive dhe mjeteve të auditimit, si dhe rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së auditimit. Në këtë aktivitet, KLSH u përfaqësua nga znj. Joniada Goçaj, drejtor departamenti, si dhe znj. Eriklida Shpori, audituese e lartë.

Në datat 29-30.06.2026 u zhvillua në Varshavë, Poloni, workshop-i tematik mbi praktikën e zhvillimit të “Peer Review”, me pjesëmarrjen me përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Kosova, Polonia, Sllovakia, Izraeli, Bullgaria, Franca, Suedia, Austria, Hungaria, Portugalia, Anglia, Malta dhe Letoni.

Falënderimet për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00